

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 43 pika 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e katërt të rregullt të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet më datë: **25.04.2019** (e enjte) duke filluar në ora **10:00**.

Rendi i ditës

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Aprovimi i Raportit financiar për tremujorin e parë Janar - Mars 2019;
3. Aprovimi i vendimit për formimin e komisionit për dhënje me qira afatshkurtër të vendgjahishtës së Komunës së Novobërdës;
4. Dhenja e pelqimit EccoHigienes, për pagesen e participimit për mirëmbajtje të ambientit me 1,6,8 Maj 2019;
5. Aprovimi i vendimit për formimin e KKSB-së;
6. Aprovimi i Statutit të QKMF-së Kufcë e Eperme;
7. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet ne lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 15.04.2019
Në: Novobërdë



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tretë e rregulltë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 28.03.2019, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, Nënkryetari për Komunitete Bajrush Ymeri, Nënkryetari i Komunës Sinisa Dimic, anëtarët e Kuvendit: Ivica Cenic, Mirjana Simijonovic, Jorgovanka Filic, Dragana Dimic, Abdyl Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhju, Dobrivoje Djordjevic, Predrag Stojkovic, Drejtori i Financave Sercan Todorovic, përfaqësuesi i OSBE-es, zyrtar dhe qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit Nebojsa Arsic pasi përshendeti të pranishmit tha: para se të fillojm me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë 12 antarët të Kuvendit dhe kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;
2. Aprovimi i Raportit Financiar tremujor të katër Tetor- Dhjetor 2018;
3. Aprovimi i Raportit Financiar Vjetor 2018;
4. Raporti i DAK-ut mbi perfundimin e gjysëmvetorit të parë për vitin shkollor 2018/19;
5. Aprovimi i propozimit për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake nga viti 2018 në vitin 2019;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti të pranishmit se a pajtohen me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?.

Nënkryetari i Komunës Sinisa Dimic pasi pershendeti të pranishmit tha: e kam një propozim për rend dite, ne nuk kemi pasur mundësi tju dergojm materialin më heret pasi që para pak ditëve kemi marrë materilin nga MAPL-ja, bëhet fjal për marrëveshje bashkpunim në mes të Komunës së Novobërdës dhe Komunës së Kamenices për dy projekte për asfaltim të rrugëve dhe këto dy projekte janë në interes të dy Komunave si për qytetarët e Komunës së Novobërdës ashtu edhe për qytetarët e Komunës së Kaminices, andaj ju kisha lut që ta aprovoni për rend dite, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: e keni degjuar propozimin e hidhi në votim propozimin e Nënkryetarit.

Aprovohet njëzëri nga të gjithë antarët prezent të Kuvendit kjo pikë e propozuar nga Nënkryetari i Komunës.

Pasi pat propozime tjera rendi i ditës u aprovua njëzëri nga të gjithë antarët prezent të Kuvendit me këtë pikë shtesë të propozuar.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pat vëretje procesverbali u aprovua njëzëri nga të gjithë antarët prezent të Kuvendit.

Pika e dytë: Aprovimi i Raportit Financiar tremujor të katër Tetor- Dhjetor 2018;

Për këtë pikë Kryesusi ja dha fjalën Drejtorit të Financave Sercan Todorovic;

Sercan Todorovic pasi përshëndeti të pranishmit tha: materialin e keni marrë me heret dhe unë në pika të shkurta po ju prezantoj, të hyra e pergjithshme për këtë tremujor në total kanë qenë 44,514€, të hyrat nga tatimi në pronë kanë qenë 9,763€, të hyrat nga regjistrimi i automjeteve 4,500€, taksa Komunale për leje ndertimi 8,107€, taksa Komunale për regjistrimin e trashigimisë 510€, taksa për ndrrimin e destinacionit të Tokës 10,085€, taksat për qertifikata të lindjes 810€, taksat për qertifikatat e kurorizimit 150€, taksa për qertifikatat e vdekjes 263€, taksat tjera administrative 477€ si dhe taksat tjera i keni të praqitur. Mjetet e shpenzuara për paga dhe medijtë kanë qenë 468,788€, mallra dhe shërbime 72,066€, subvencione 2,150€ dhe investime kapitale 199,286€ kto janë shifrat totale i keni në material për secilen Drejtori nese keni ndonjë pyetje urdhëroni, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti pasi përshëndeti të pranishmit tha: raportin e kemi marrë më herët dhe kemi pasur kohë mjaftueshem që ta analizojm, andaj ju kisha bërë disa pyetje te mjetet e shpenzuar, subvencionim të zyrja e Kryetarit 2,150€ me intereson të di se çka keni subvencionuar?, të kategoria shpëzimet tjera të kontraktuara nuk janë cekur se çka është shpenzuar dhe me intereson të di se ku janë shpenzuar këto mejte në vlerë prej 4,154€, të zyrja për komunitete shpenzimet e pagave për 2 muaj janë 0 ndërsa për pije dhe ushqim janë shpenzuar 1,043€ me intereson të di se kush i ka shpenzuar këto?. Mos të hy ne detale por të gjithë analizen që e kam bërë del se kodi që është shumë i dyshimt që mos të votohet ky raport është se të 14,044€ janë shpenzime tjera të kontraktuara. Shihet se keni bërë shumë shpenzime dhe një menaxhim jo të mirë 8,893€ shpenzime për transport në kode të ndryshme buxhetore dhe në total për tremujorë janë shpenzuar 3,673€ shpenzime telefoni pa i llogaritur shpenzimet telefonike të Kuvendit, andaj kërkoj prej ju që të na raportoni se ku janë bërë këto shpenzime si në subvencione në zyre të Kryetarit dhe këto shpenzimet tjera të kontraktuara.

Sercan Todorovic tha: fillimisht për subvencione ato janë ndihmë që ju bëhet qytetraëve të Komunës tonë në rast se kan ndonjë sëmundje, bëjnë kërkes të ne dhe ne ju ndihmojm ndërsa të shpenzimet tjera të kontraktuara janë ato shpenzime si furnizim me material për zyre dhe shpenzime tjera, ndërsa sa i perket shpenzimeve telefonike janë obligime të tremujorit andaj është pak shumë e madhe.

Ramush Mehmeti tha: kërkoj nga Kuvendi që mos të aprovohet ky raport pasi që Drejtori nuk po na informon se ku janë shpenzuar 14,044€.

Pasi nuk pat diskutime tjer Kryesusi e hudhi në votim këtë pikë të rendit të dites.

Me 3 vota për, 8 kunder(Nebojsa Arsic, Ramush Mehmeti, Abdyl Gashi, Selatin Nuhiu, Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Ivca Cenec, Dragana Dimic) dhe 1 apstenim nuk aprovohet Raporti i tremujorit të katër Financiar për vitin 2018.

Sercan Todorovic tha: i pyes antarët e Kuvendit se pse kan votuar kunder, pasi që unë nuk i pregadis të hyrat as nuk i bëj shpenzimet por vetem numrat i marrë në sistem, ju si duket po pregaditeni më heret që mos të votoni, vetem vazhdoni.

Pika e tretë: Aprovimi i Raportit Financiar Vjetor 2018;

Për këtë pikë Kryesusi ja dha fjalën Drejtorit të Financave.

Sercan Todorovic tha: edhe këtë raport e keni marrë më heret dhe është shtyer për qështje të cilat i dini dhe besoj se keni pasur kohë mjaftueshem që ta shqyrtoni, sigurisht që jeni dakorduar që të votoni kunder, nese keni ndonjë pyetje urdhëroni.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi pasi përshëndeti të pranishmit tha: në këtë raport ka shumë shkelje dhe paqartësi, te shpenzimet faqe 6 tabela 3 është medijtë jashtë vendit 1,000€ ndërsa të e njehta faqe është avanse për udhëtime zyrtare janë 2,000€ dhe ne asnjë herë nuk kemi pasur ndonjë raportim qoftë prej Kryetarit apo ndonjë zyrtari tjetër për benfitet që i ka pasur Komuna jonë me këto udhëtime jasht vendit, denime

gjyqësore është 2,000€ dhe ne nuk po e dim se çka keni paguar me këto 2,000€, ndërsa e kemi te një kod tjetër vendime gjyqësore që janë 35.000€ në fakt janë 38,000€ te shpenzimet faqe 6, më intereson të di se çka është paguar, tjetri shpenzim është dreka zyrtare që është 3,000€ në kolonen e parë dhe 3,000 € në kolonen e dytë ndërsa gjithsej kalkulimi është 5,000€. Edhe ky raport është shumë i mangët, te veshja sportive shpenzimet janë 21,000€ ndërsa e dim që sallen kryesore e kemi jashtë funksionit në Llabjan ku mendoj se me një shumë prej 500-600€ mundë të rregullohet ai ndriqim, të shpenzime kontraktuale të tjera është 170,000€ dhe këtu kërkoj një sqarim prej Drejtorit, ju faleminderit.

Sercan Todorovic tha: sa i përket meditjeve ato janë meditje për zyratër të cilët kanë ndjekur seminare jashtë vendit, 5000€ janë para të gatshme të Kryetarit i cili ka të drejt ti shpenzoj, denimet prej 2000€ janë sepse e kemi humbur një rast në gjykatë ndërsa aty 3000+3000 mundet me qenë gabim teknik. Në këtë raport e pregadismi dhe e dergojm në Ministri dhe Ministria e kontrollon dhe e aprovon e sa i përket Kuvendit nuk e di a duhet ta aprovoj pas që më shumë duhet të jetë vetem një informat.

Abdyl Gashi tha: nuk thash që duhet të na jep llogaritje por një informat se çfarë benificone ka përfituar Komuna për udhëtime jashtë vendit pasi që këto mjete janë të taksapaguesve të qytetarëve, 170,000€ janë kontrata të tjera dhe pres pergjigje, 180,000€ janë suficit prej Komunës janë para që kanë tepruar, ku dihet se Komuna e ka një buxhet shumë të vogël dhe është një teprim shumë i madhë dhe nuk ka arrit që kjo qeverisje të menaxhoj që qeveris së bashku me LDK-n.

Sercan Todorovic tha: nuk është e vertet se Komuna i ka humbur ato mjete pasi që 480,000€ kanë qenë të planifikuara, 380,000€ nga granti qeveritar, nga të hyrat 395,000€ që është duhur që ti shpenzojm, 370,000€ i kemi shpenzuar në suficit kanë shkuar vetem rreth 21,000 € të cilat janë mjete që i kemi angazhuar në Prekovic por Kompania nuk ka mundur ti kryej punët me kohë.

Abdyl Gashi tha: po flas në bazë të dhënave që i kemi në tabel, suficit nuk kanë shkuar 21,000€ sa po thu ti por në bazë të kalkulimeve që kemi bërë janë 180,000€ suficit dhe kjo është e dhënë zyrtare.

Sercan Todorovic tha: si duket nuk po kuptohemi ato mjete kanë qenë vetem të planifikuara e nuk janë të realizuara dhe ato nuk mundë ti humbim, mendoj se jamë i qartë, nuk janë mjete të humbura ato që nuk i kemi realizuar.

Ramush Mehmeti tha: zt.Drejtor nese ke marrë një detyr që nuk ki mundësi ta kryesh më mirë është me dhën dorheqje dhe nese ti mendon se nuk ki të drejt mi raportu Kuvendit për shpenzime të buxhetit e ki gabim, antarët e Kuvendit duhet ta din për çdo buxhet ku është shpenzuar, kur të bihet raport në Kuvend duhet të mbrohet, kërkoj perseri nga anatarët që mos të aprovohet, ju faleminderit.

Selatin Nuhiu pasi përshendeti të pranishmit tha: në këtë raport ka shumë mosperputhje të mëdha, p.sh te të hyrat vetanake në bartje në tabel figuron se janë 40,000€ ndërsa në një tabel të gatshme që na është ofruar është 65,000€ është një diferenc prej 25,000€. Te tabela nr.3 sherbime dhe mallra ka shumë mosperputhje, te tabela e shpenzimeve telefonike janë grant qeveritar 1,000€, të hyra vetanake 6,000€ këto bëjnë gjithsej 7,000€ ndërsa në tabel figurojn gjithësej 8,000€, furnizim me ushqim dhe pije 3,000€ grant qeveritar, 9,000€ të hyra vetanake bëjnë 13,000€ ndërsa ju e keni cek 11,000€, te permbaruesi privat 38,000€ kjo është një shumë e madhe, ju faleminderit.

Sercan Todorovic tha: sa i përket permbaruesit i kemi pasur disa obligime të cilat nuk kemi pasur mundësi ti kryejm dhe permbaruesi i ka marrë ato mjete që kanë qenë të lira, ndërsa sa i përket atyre gabimeve teknike ndoshta është duhur që edhe ZKF të jetë prezent por për arsye të disa obligimev nuk ka pasur mundësi të vij andaj ju kërkoj falje.

Pasi nuk pati tjera diskutime Kryesuesi e hudhi në votim këtë pikë.

Me 3 vota për, 8 kunder(Nebojsa Arsic, Ramush Mehmeti, Abdyl Gashi, Selatin Nuhiu, Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Ivca Cenec, Dragana Dimic) dhe 1 nuk ishte prezent nuk aprovohet Raporti Vjetor Financiar për vitin 2018.

Pika e katërt: Raporti i DAK-ut mbi perfundimin e gjysëmvjetorit të parë për vitin shkollor 2018/19; Kryesuesi për këtë pikë ja dha fjalën Zyrtarit për Arsim Flamur Uka.

Flamur Uka pasi pershendeti të pranishmit tha: ne e kemi dorzuar raportin për përfundimin e vitit shkollor 2018/19. DAK sot do ta paraqes raportin para jush për përfundimin e gjysëmvejetorit të parë të vitit shkollor 2018/19. Me lejoni tju informoj se fillimi i gjysëmvejetorit të parë ka qenë i rregulltë dhe nuk ka pasur ndonjë problem që vlen të theksohet, sigurisht që problemet e vazhdueshme na kan percjell edhe në këtë gjysëmvejetor siç është sasia e vogel e buxhetit në të gjitha kategorit buxhetore por me e ndejshme ka qenë ajo në kategorin e mallrave dhe sherbimeve. DAK-u konfrom pergjegjësive të saja ka analizuar dhe mbajtur të gjitha aktivitetet në shkolla të parapara. Bashkangjitur gjithashtu i keni tabelat të cilat i dergojmë edhe ne Ministri, ku është i paraqitur suksemi i nxënësve. Pasi që e keni raportin nuk kisha shtu diçka tjetër nese keni ndonjë pyetje udhëroni, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha: cili është Drejtori i këtij zyrtari të arsimit dhe prej kujt kontorllohen raportet nga cili Drejtor?, kisha qenë shumë i mirëkuptueshem nese ma tregon emrin e Drejtorit të Arsimit.

Flamur Uka tha: është një pyetje që unë nuk mundë të jep pergjigje pasi që jamë zyrtarë, hirearkia është më e nalt se e imja, ndërsa sa i përket raportit unë e di se gjithom unë kam raportuar por gjithmon me Drejtorin e kemi perpiluar raportin mirepo duke e pasur parasysh se ky raport është i obliguar sipas kalendarit të Kuvendit e kemi pa të arsyeshme që me prezantu në Kuvend, sa i përket të dhënave që janë në këtë raport garantoj se këto janë të dhëna të sakta dhe janë dhënë nga Drejtorët e shkollave.

Abdyl Gashi tha: thjesht pyeta, një zyrtarë i cili nuk e njef Drejtorin e vet, cili Drejtor e kontrollon këtë raport që na e ke prezantu sot në Kuvend?, kush është Drejtori?, si e ka emrin?

Flamur Uka tha: duke e pasur parasysh se raporti e ka emrin tim këtu nuk ka pasur Drejtor i cili e ka kontrolluar, besoj qe isha i kuptueshem pasi që nuk jamë pozit udhëheqëse për të prezantuar Drejtorin.

Milica Jovanovic pasi pershendeti të pranishmit tha: po lidhem në këtë pikë pasi që në këtë flet qe kem perpara shkuruhet emri i zyrtarit ndërsa në email është i Drejtorit i Arsimit.

Selatin Nuhui tha: ne po dojnë me dit se kush është ai Drejtor a është, kjo është papergjeshmeri kam treguar edhe në KPF që për Kuvend së paku të jetë edhe Drejtori prezent.

Kryesusi tha: pasi nuk ka tjera diskutime kalojm në piken e radhes.

Pika e pestë: Aprovimi i propozimit për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake nga viti 2018 në vitin 2019;

Per këtë pikë Kryesusi ja dha fjalën Drejtorit të Financave.

Sercan Todorovic pasi pershendeti të pranishmit tha: e keni marr materialin për bartje të këtyre mjeteve se në cilat kategori do të bëhet bartja dhe ne na duhet vendimi për bartje të këtyre mjeteve, shuma totale është 65,409.30€, në kategoria mallra dhe sherbime janë ne vlerë prej 6,199.58 €, kategoria e sherbimeve komunale në vlerë prej 49.35 €, Kategoria e Subvencioneve në vlerë prej 6.06€, kategoria e investimeve kapitale 59,154.31 €.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: prezantimi është në rregull po e kam një pyetje te investimet kapitale 59,000€ ku shkojnë?.

Sercan Todorovic tha: këto mjete janë për particim në projekte si dhe asfaltim dhe mirëmbajtje të rugëve lokale.

Pasi nuk pati tjera diskutime tjera u hudh në votim Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake nga viti 2018 në vitin 2019 dhe aporovohet njëzëri kjo pikë dhe bihet ky:

V E N D I M

Aprovohet vendimi për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake në shumë prej 65,409.30 € të vitit 2018 në vitin 2019.

Pika e gjashtë: Aplikimi në Projekte në bashkpunim më Komunen e Kamenices;

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Sinisa Dimic tha: edhe ne fillim e ceka se jemi vonuar me material, kemi pasur takime ede me Kryetarin dhe këto projekte janë në interes të të dy Komunave pasi që bëhet fjalë për infrastrukturë që do të ndikonte në të dy Komunitet andaj propozoj se do të votojmë për këto projekte.

Abdyl Gashi tha: pasi që kjo pikë na u propozu sot në mënyrë që mos të bëjmë ndonjë veprim të ngutshëm kërkojmë një pauzë që të konsultohemi më asamblistë të tjerë.

Jorgovanka Filip pas përkrahjes së pranishmit tha: unë e di ku është kjo pjesë e rrugës dhe ju ftoj që ta votojmë pasi që është për të mirën e qytetarëve të dy Komunave e sidomos për Komunitetin tonë, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: pauzë 5 min për konsultim.

Pas pauzës 5 minutshe Kryesuesi tha: është një propozim nga nënkryetari për projekte në bashkëpunim me Komunitetin e Kamincës që është në interes të të dy Komunave, e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha: mendoj se projektet të cilat janë në shërbim dhe të mirën e qytetarëve pa dallim etnie duhet të përkrahim.

Pasi nuk pat diskutime tjera u hadh në votim kjo pikë, u votua njëzëri dhe u prur ky:

V E N D I M

Aprovohet propozimi për dhënien e pajtueshmërisë për aplikim në projektet ndërkomunale, bashkëpunim në mes të K.K Kamencës dhe Novobërdës.

Pika e gjashtë: Të ndryshme;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Predrag Stojkovic pas përkrahjes së pranishmit tha: e kam një pyetje për Kryesuesin pasi që para katër muajve qytetarët e fshatit Koretishtë e kanë paraqitur një problem para jush me shkrim andaj kërkojmë nga ju një informatë se deri ku keni marrë a keni punuar lidhur me këtë qështje, rruga lokale është shumë e dëmtuar dhe nga ju kemi kërkuar që të bëhet kufizimi i mjeteve me peshë të rëndë, dhe e dyta numri i gurthyesve çdo ditë e më shumë po rritet dhe askush nuk po ndermerr asgjë, gjithashtu kërkojmë nga ju që të formoni një komision që të vërtetojë këtë që po e them unë, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: po e di kërkesën që ka ardhur nga qytetarët e fshatit Koretishtë, Kuvendi do të përkrahë zgjidhjen e këtij problemi por Drejtoria e Shërbimeve Publike duhet ta përgadisë këtë vendim por përse Drejtoria e shërbimeve publike pse nuk e ka prur këtë vendim në Kuvend nuk e di.

Predrag Stojkovic tha: ju duhet të merreni me këtë qështje pasi që kërkesa ju është drejtuar Kuvendit, ne nuk kemi asnjë informatë se a keni punuar diçka në lidhje me këtë kërkesë.

Kryesuesi tha: po, Kuvendi do të aporvojë vendimin për ndalesë të qarkullimit të automjeteve me peshë të rëndë por D.SH.P duhet ta përgadisë dhe ne si Kuvend do ta përkrahim.

Predrag Stojkovic tha: mendoj se edhe në mënyrë logjike duhet që tju përgjigjeni qytetarëve duhet t'ju njoftoni se kujt qytetarët duhet t'ju drejtohen.

Kryesuesi tha: me rekomandim të D.SH.P Kuvendi do ta bjerë vendimin.

Predrag Stojkovic tha: duhet ta shikoni procesverbalin e mëldhjeve të kaluara kur e kam paraqitur këtë kërkesë.

Dobrovoje Djordjevic pas përkrahjes së pranishmit tha: pyetja ime nuk ka vlerë pasi që Nënkryetari e lëshoj mëldhjen, por bëhet fjalë për rrugën e Stanishorit të gjithë e din se si është gjendja, unë nuk e di se ku të ankojemi deri ku ka arritur kjo punë?, a po mirret dikush me këtë qështje dhe kush po e stopon këtë?, ka kaluar një vit dhe ende askush nuk po mirret me këtë problem apo duhet që përseri të organizojmë protest, ju faleminderit.

Mirjana Simijonovic pas përkrahjes së pranishmit tha: unë po nderlidhem me atë që thanë kolegët, po pyes se kush po lejon që të ketë kaq shumë gurthyes të ndertohen në një vend?, kërkesës tonë duhet t'ju përgjigjet Kuvendi me kohë, pse të pritët kaq shumë për rregullimin e një rruge.

Ramush Mehmeti tha: kërkesa është e arsyeshme, të gjithë ne po dimë se ku është problemi por spo përmendim emra, Kuvendi për këtë mandat çdo herë ka qenë në anën e qytetarëve, në vitin e kaluar e kemi

Procesverbali i Kuvendit


marrë një vendim për alokim të mjeteve për ndriqim publik në fshatin Pasjak ndërsa ndriqimi nuk është bërë, muaji mars ka kalua dhe Kryetari i Komunës nuk i raporton Kuvendit edhe pse është obligativ që të raportoj, ju faleminderit.

Milica Jovanovic tha: e kemi marrë edhe një propozim për formimin e KKSB.

Kryesusi tha: jo nuk është askush për këtë pikë.

Pasi nuk pat diskutime tjera Kryesuesi i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.
Mbledhja përfundoi në ora 11:20.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



RAPORTI FINANCIAR

TË HYRAVE DHE TË DALURAVE PËR PERIUDHËN

JANAR - MARS 2019

PRILL - 2019

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E NOVOBERDES - OPSTINA NOVO BRDO
DALLES - IZLAZNA
NRID: 05-211
Mbledhja: 15.04.2019
NOVOBERDE - NOVODRDO

Shfrytezimi I te hyrave dh te dalurave te shfrytezueseve buxhetor per periudhen Janar-Mars

Per te pasur nje pasqyr te shfrytezuesve buxhetor po ju paraqesim raportin e shpenzimeve te planifikuara dhe te shpenzuara per periudhen janar-Mars 2019

Nr	Shfrytezuesit e buxhetit	Kod	Kod I drejtoris
1	Zyra e Kryetarit		16030
2	Administrata		16330
3	Zyra per komunikim		16490
4	Zyra per barayr gjinore		16530
5	Zyra e kuvendit komunal		16930
6	Buxhet dhe financa		17530
7	Inspekcioni		16659
8	Sherbimet publike - mbrojtja civile		18190
9	Zyra per komunitete		19650
10	Bujqesi, pylltari dhe zhvill. rur.		47030
11	Zhvillim ekonomik		48030
12	Urbanizem		66455
13	Shendetesi dhe mbrojtje prim. Shend.		74800
14	Sherbimet sociale		75645
15	Kultur nini dhe sport		85030
16	Administrata arsim		92150
17	Arsim I mesem		95070
18	Arsim filior		93870
19	Arsimi parashkollor kopshtet		92790

Inkasimi eshte bere ne baze te Rregullores mbi taksat, ngarkesat dhe kamatat si dhe Rregullores per tatimin ne prone

Per tremujorin e pare 2019 I kemi keto te hyra

tw hyrat vetanak per muajt Janar, Shkurt, Mars

40110	Te hyrat nga tatimi ne pron	10,530.26
50001	Te hyrat nga regi. I automjeteve	3,040.00
50009	Taksa komunale per leje te ndertimit	282.00
50011	Taksa komunale per regjistrimin e trasheg.	110.00
50012	Taksa per ndrimin e destinationit te tokes	15,439.00
50013	Taksa per qertifikatat e lindjes	565.00
50014	Taksa per qertifikatat e kunorezimit	94.00
50015	Taksa per qertifikata te vdjeke	83.00
50019	Taksa tjera administrative	511.00
50019	Taksa per vertetimet prej 1€	304.00
50019	Taksa tjera administrative - Lista poseduse	4,005.00
50408	Qiraja nga objektet publike	300.00
50405	Qiraja nga prona publike	150.00
50409	Te hyrat nga konfiskimi	278.40
50019	Participimi nga shendetesia	10.00
	Gjithsej	35,701.66

MJETET E SHPENZUARA
Sipas shfrytëzuesve të njësive buxhetore

Nr	Shfrytëzuesi i buxhetit	Paga dhe medije	maltra dhe sherbime	Shpenzimet komunale	Subvencionet	Investimet kapitale
		Te planifikuara	te shpenzuara	te shpenzuara	te shpenzuara	te shpenzuara
1	Zyra e Kryetarit	€17,375.25	€17,469.02	€18,478.53		
2	Administrata	€41,800.00	€41,005.62		€18,407.16	
3	Zyra per komunikim	€1,300.00	€1,240.17			
4	Zyra per barayr gjinore	€1,800.00	€1,791.20			
5	Zyra e kuvendit komunal	€17,500.00	€15,837.57	€1,111.61		
6	Buxhet dhe financa	€11,575.00	€11,699.68			
7	Inspekcioni	€7,043.00	€7,066.41			
8	Sherbimet publike - mbrojta civile	€18,349.00	€18,365.27			
9	Zyra per komunitete	€7,726.00	€6,478.65			
10	Bujqesi, pylltari dhe zhvill. rur.	€11,025.00	€11,053.55			
11	Zhvillim ekonomik	€7,050.00	€7,106.45			
12	Urbanizem	€12,607.00	€11,964.86			
13	Shendetesi dhe mbrojte prim. Shend.	€59,788.00	€58,808.83	€3,124.05	€288.00	
14	Sherbimet sociale	€5,995.00	€6,018.79			
15	Kultur nri dhe sport	€10,162.00	€10,203.33		€165.00	
16	Administrata arsim	€10,875.00	€9,800.15		2,030.00	
17	Arsim i mesem	€48,125.00	€50,222.48	€4,573.78		
18	Arsim filior	€182,648.00	€183,831.29	€9,395.71		
19	Arsimi parashkollor kopshtet	€3,125.00	€3,140.09			
	Gjithsejt	€475,868.25	€473,103.41	€36,683.58	€20,890.16	€550.00
						€0.00

Mjetet e planifikuara per tremujorin e pare per vitin 2019 per Paga dhe Medije kan qene te planifikuara ne vler prej 475,868.25 E, kurse tw shpenzuara jane ne vler prej 473,103.41 E, ne pergjinde eshte 99.40 %.

Per maltra dhe sherbime jane shpenzuar ne vler prej 36,683.58 Euro.
Per shpenzime komunale jane shpenzuar ne vler prej 20,890.16 Euro.
Per subvencione jane shpenzuar ne vler prej 550.00 Euro.

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar-mars 2019

Per paga dhe medijte jane planifikuar ne vler prej	17,375.25 Euro,	kurse te shpenzuara jane ne vler prej	17,469.02 Euro,	ne perqindje eshte	100.5 %
Per mallra dhe shërbime jane shpenzuar ne vler prej	18,478.53 Euro				
per subvencione jane shpenzuar ne vler prej	550.00 Euro.				

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar-mars 2019

Per paga dhe medqite jane planifikuar ne vler prej	41,800.00 Euro,	kurse te shpenzuara jane ne vler prej	41,005.62 Euro,	kurse ne % eshte	98.00 %
Per shpenzime komunale jane shpenzuar ne vler prej	18,407.16 Euro,				

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar-mars 2019

Per paga dhe medije jane planifikuar ne vler prej 1,300.00 Euro, kurse te shpenzuara jane ne vliere prej 1,240.17 Euro, kurse ne % eshte 95.00 %

ZYRA PER BARAZI GUINORE 16530

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar-mars 2019

Nr	Lloji I shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.dhe sherbime	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Janar	€593.94			
2	Paga	Shkurt	€598.63			
3	Paga	Mars	€598.63			
	Gjithsej		€1,791.20			

Per paga dhe medije jane planifikuar ne vler prej 1,800.00 Euro, kurse te shpenzuara jane ne vlere prej 1,791.20 Euro, kurse ne % eshte 99.50%.

ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL 16930

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar-mars 2019

Nr	Lloji I shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.dhe sherbime	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Janar	€5,269.03	ushq dhe pije	€430.60	
2	Paga	Shkurt	€5,284.27	Furniz. per Zyr	€171.01	
3	Paga	Mars	€5,284.27	shpenz. e tel.	€510.00	
	Gjithsej		€15,837.57		€1,111.61	

Per paga dhe medije jane planifikuar ne vler prej 17,500.00 Euro, kurse te shpenzuara jane ne vlere prej 15,837.57 Euro, kurse ne % eshte 90.50%.
Per mallra dhe sherbime jane shpenzuar ne vler prej 1,111.61 od Euro

BUXHET DHE FINANCA 17530

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar-mars 2019

Nr	Lloji I shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.dhe sherbime	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Janar	€3,884.22			
2	Paga	Shkurt	€3,907.73			
3	Paga	Mars	€3,907.73			
	Gjithsej		€11,699.68			

Per paga dhe medije jane planifikuar ne vler prej 11,575.00 Euro, kurse te shpenzuara jane ne vlere prej 11,699.68 E Euro, kurse ne % eshte 101.00 %.

INSPEKSIONI 16659

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar-mars 2019

Nr	Lloji I shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.dhe sherbime	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Janar	€2,344.89			
2	Paga	Shkurt	€2,360.76			
3	Paga	Mars	€2,360.76			
	Gjithsej		€7,066.41			

Per paga dhe medije jane planifikuar ne vler prej 7,043.00 Euro, kurse te shpenzuara jane ne vlere prej 7,066.41 Euro, kurse ne % eshte 100.00 %.

SHERBIME PUBLIKE 18190

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar-mars 2019

Nr	Lloji I shpenzimeve	Muaji	Paga	Mail.dhe sherbime	Vlera	Invest.kapitale	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Janar	€6,106.17					
2	Paga	Shkurt	€6,129.55					
3	Paga	Mars	€6,129.55					
	Gjithsej		€18,365.27				€0.00	€18,365.27

Per paga dhe medije jane planifikuar ne vler prej 18,349.00 Euro, kurse te shpenzuara jane ne vlere prej 18,365.27 Euro, kurse ne % eshte 100.00 %.

ZYRA PER KOMUNITETE 19650

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar-mars 2019

Nr	Lloji I shpenzimeve	Muaji	Paga	Mail.dhe sherbime	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Janar	€2,150.91			
2	Paga	Shkurt	€2,163.87			
3	Paga	Mars	€2,163.87			
	Gjithsej		€6,478.65			

Per paga dhe medije jane planifikuar ne vler prej 7,726.00 Euro, kurse te shpenzuara jane ne vlere prej 6,478.65 Euro, kurse ne % eshte 84.00 %.

BUQESI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL 47030

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar-mars 2019

Nr	Lloji I shpenzimeve	Muaji	Paga	Mail.dhe sherbime	Vlera	Kapitale	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Janar	€3,672.97					
2	Paga	Shkurt	€3,690.29					
3	Paga	Mars	€3,690.29					
	Gjithsej		€11,053.55				0.00	11,053.55

Per paga dhe medije jane planifikuar ne vler prej 11,025.00 Euro, kurse te shpenzuara jane ne vlere prej 11,053.55 Euro, kurse ne % eshte 100.00 %.

ZHVILLIM EKONOMIK 48030

Tabe Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar-mars 2019

Nr	Lloji I shpenzimeve	Muaji	Paga	Mail.dhe sherbime	Vlera	Kapitale	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Janar	€2,372.20					
2	Paga	Shkurt	€2,387.26					
3	Paga	Mars	€2,346.99					
	Gjithsej		€7,106.45				0.00	€7,106.45

Per paga dhe medije jane planifikuar ne vler prej 7,050.00 Euro, kurse te shpenzuara jane ne vlere prej 7,106.45 Euro, kurse ne % eshte 100.50 %.

URBANIZEM

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar-mars 2019

66455

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall dhe sherbime	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Janar	€4,107.27			
2	Paga	Shkurt	€3,679.88			
3	Paga	Mars	€4,177.71			
Gjithsej			€11,964.86			

Per paga dhe medite jane planifikuar ne vier prej 12,607.00Euro, kurse te shpenzuara jane ne vhere prej 11,964.86 Euro, kurse ne % eshte 95.00 %.

MBROJTJA PRIMARE SHENDETESORE

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar-mars 2019

74800

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall dhe sherbime	Vlera	shp.komunale	Vlera
1	Paga	Janar	€19,521.83	Furniz.per zyr	€199.30	Rryma	€170.00
2	Paga	Shkurt	€19,643.50	ushq.dhe pije	€661.20	shpenz.e tel.	€118.00
3	Paga	Mars	€19,643.50	Paga	€525.00		
				Derivate	€1,198.55		
				shp.mbush.tel.	€540.00		
Gjithsej			€58,808.83		€3,124.05		€288.00

Per paga dhe medite jane planifikuar ne vier prej 59,788.00 Euro, kurse te shpenzuara jane ne vhere prej 58,808.83 Euro, kurse ne % eshte 98.00 %.

Per shpenzime komunale jane shpenzuar ne vier prej 288.00 Euro.

Per mallra dhe sherbime jane shpenzuar ne vier prej 3,124.05 od Euro

SHERBIME SOCIALE 75646

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar-mars 2019

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall dhe sherbime	Vlera	shp.komunale	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Janar	€1,997.97					
2	Paga	Shkurt	€2,010.41					
3	Paga	Mars	€2,010.41					
Gjithsej			€6,018.79					

Per paga dhe medite jane planifikuar ne vier prej 5,995.00 Euro, kurse te shpenzuara jane ne vhere prej 6,018.79 Euro, kurse ne % eshte 100.50 %.

KULTUR RINI DHE SPORT 85030

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar-mars 2019

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall dhe sherbime	Vlera	shp.komunale	Vlera
1	Paga	Janar	3,387.31			Rryma	€ 165.00
2	Paga	Shkurt	3,408.01				
3	Paga	Mars	3,408.01				
Gjithsej			10,203.33				€ 165.00

Per paga dhe medite jane planifikuar ne vler prej 10,162.00 Euro, kurse te shpenzuara jane ne vlere prej 10,203.33 Euro, kurse ne % eshte 100.50 %.

Per shpenzime komunale jane shpenzuar ne vler prej 165.00 Euro.

ADMINISTRATA NE ARSIM 92150

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar-mars 2019

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall dhe sherbime	Vlera	shp.komunale	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Janar	€3,109.35			Rryma	1,780.00	
2	Paga	Shkurt	€3,122.88			shpenz e tel.	250.00	
3	Paga	Mars	€3,567.92					
Gjithsej			€ 9,800.15				2,030.00	

Per paga dhe medite jane planifikuar ne vler prej 10,875.00 Euro, kurse te shpenzuara jane ne vlere prej 9,800.15 Euro, kurse ne % eshte 90.00 %.

Per shpenzime komunale jane shpenzuar ne vler prej 2,030.00 Euro.

ARSIMI I MESEM 95070

Tabe Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar-mars 2019

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall dhe sherbime	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Janar	€ 16,667.59	kontra te tjera	€ 643.00	
2	Paga	Shkurt	€ 16,778.72	serv. i automjeteve	€ 456.00	
3	Paga	Mars	€ 16,776.17	Dreka	€ 125.00	
				Furnizim per zyr	€ 534.77	
				Permb. privat	€ 741.01	
				Trans. nensive	€ 1,975.00	
				ushq dhe pije	€ 99.00	
Gjithsej			€ 50,222.48		€ 4,573.78	€ 50,926.89

Per paga dhe medite jane planifikuar ne vler prej 48,125.00 Euro, kurse te shpenzuara jane ne vlere prej 50,222.48 Euro, kurse ne % eshte 104.00 %.

Per mallra dhe sherbime jane shpenzuar ne vler prej 4,573.78 Euro

ARSIIMI FILLOR 93870

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen janar-mars 2019

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Muaji dhe shprehja	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Janar	661,346.81	Kontrata tjera	€ 545.00	
2	Paga	Shkurt	661,811.71	Turniz i dozimet	€ 194.00	
3	Paga	Mars	€ 60,672.70	Kontrata tek.	€ 30.00	
				Shp. i autom.	€ 184.08	
				Furniz. per zyr	€ 323.80	
				taks. regj. auto.	€ 75.00	
				Usq. dhe pije	€ 382.81	
				Permb. privat	€ 6,342.47	
				Trans. nxensve	€ 1,190.35	
				shp. tel. l.pko	€ 50.00	
				Med. per udh. zyr.	€ 78.00	
Gjithsej			€183,831.22		€ 9,395.51	€ 178,749.84

Per paga dhe medite jane planifikuar ne vler prej 182,648.00Euro, kurse te shpenzuara jane ne vlere prej 183,831.22 Euro, kurse ne % eshte 100.50 %.

Per malira dhe sherbime jane shpenzuar ne vler prej 9,395.71 Euro

ARSIIMI PARASHKOLLOR DHE QERDHET

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen janar-mars 2019

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Gjithsej
1	Paga	Janar	€ 1,041.03	
2	Paga	Shkurt	€ 1,049.53	
3	Paga	Mars	€ 1,049.53	
Gjithsej			€ 3,140.09	

Per paga dhe medite jane planifikuar ne vler prej 3,125.00 Euro, kurse te shpenzuara jane ne vlere prej 3,140.09 Euro, kurse ne % eshte 100.50 %.

Z. Srdjan Todorovic
Drejtor per Buxhet dhe Financa


[Signature]



Z. Svetislav Ivanovic
Kryetar i Komunes

[Signature]





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada- Government

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

DEPARTAMENTI I PYLLTARISË / DEPARTMENT SUMARSTVA/ FORESTRY DEPARTMENT

DATE/A:	06.03.2019
REFERENC-Ë:	05/15/2019
PËR/ZA/TO:	z. Avdi Vllasaliu, Zyrtar i Departamentit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, kk -Novobërdë;
CC:	z. Kapllan Halimi, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit; z. Svetislav Ivanovic, Kryetar i Komunës së Novobërdës;
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Tahir Ahmeti, Drejtor i Departamentit të Pylltarisë në MBPZHR;
NGA/OD/FROM:	Bajram Batusha, Divizioni për Politika Menaxhimi me Kafshë të Egra, Gjueti dhe Ekoturizem;
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim:

Te nderuar:

Ju njoftojmë përmes kësaj shkrese se stafi përgjegjës i Departamentit të Pylltarisë bëri shqyrtimin e kërkesës tuaj, Nr. 561/11 të datës 13.02.2019 lidhur me dhënien e pëlqimit për themelimin e dy vendgjuetive të përbashkëta në komunën e Novobërdës dhe konstatoj se kërkesa nuk mund të shqyrtohet nga komisioni ministror, për këtë arsye:

Komuna e Novobërdës përmes drejtorisë përkatëse me datën 25.10.2017 ka bërë kërkesën Nr.3743/24 për themelimin e vendgjuetise së përbashkët të emërtuar "Kalaja", ku pas shqyrtimit të komisionit ministror për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave u dha propozimi për dhënie të pëlqimit për themelimin e vendgjuetise në fjalë, me pastaj i miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MBPZHR me datën 15.12.2017, NR.3743/3.

Bashkangjitur shkrësës e keni pëlqimin e miratuar të themelimit.

Respekt



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry And Rural
Development*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of
the Secretary General*

Datë: 08.12.2017
Ref. ZSP.1055/17

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke
marrë parasysh nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të
Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, dt. 21 tetor 2010), duke u bazuar në
nenin 17 (paragrafi 5 dhe 6) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë
administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), si dhe në bazë të
nenin 19 paragrafi 19.2 të Ligjit Nr.02/L-53 Për Gjuetinë (GZ, nr.8/01 Janar 2007 dhe
nenit 8 paragrafi 8.1, 8.4 dhe 8.5 Udhëzimit Administrativ NR.10/2007 Kriteret e
caktimit të zonave dhe procedurat për themelimin e vendgjuetive, dt. 14/09/2007,
Nxjerr:

P Ë L Q I M

**PËR THEMELIMIN E VENDGJUETISË TË PËRBASHKËT NË KOMUNËN E
NOVOBERDES**

1. Jepet PËLQIMI për themelimin e vendgjuetisë së përbashkët " KALAJA " në
territorin e Komunës së Novobërdës me sipërfaqe të përgjithshme prej 23.780.00 ha, si
dhe me sipërfaqe prej 16.000.00 ha ku mund të kryhen aktivitete të gjuetisë, sipas hartës
dhe dokumentacionit të kompletuar, bashkangjitur kërkesës për dhënie të Pëlqimit për
Themelimin e Vendgjuetisë së Përbashkët.

2. Vendgjuetia e përbashkët nga pika 1 e këtij Pëlqimi, me qëllim të menaxhimit të
qëndrueshëm të kafshëve të egra dhe rregullimit të tyre në aspektin administrativ, duhet
të jetë e qëndrueshme e shfrytëzuar sipas tërësisë së ekosistemit, baraspeshës ekologjike,
kultivimit, mbrojtjes, dhe shtimit të kafshëve të egra si pasuri natyrore kombëtare me
interes të përgjithshëm që gëzon mbrojtje të veçantë në harmoni me nenin 19 paragrafi
19.2 dhe të Ligjit Nr.02/L-53 për Gjuetinë, (GZ, Nr.08, dt.01.01.2007) dhe nenit 8
paragrafi 8.1, 8.4 dhe 8.5 Udhëzimit Administrativ NR.10/2007 Kriteret e caktimit të
zonave dhe procedurat për themelimin e vendgjuetive, dt. 14/09/2007.

3. Obligohet Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e komunës së Novobërdës, për zbatimin këtij pëlqimi sipas procedurave të legjislacionit në fuqi.

4. Pëlqimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, duke u bazuar në autorizimet ligjore në fuqi, nenin 19.paragrafi 19.2 të Ligjit Nr.02/L-53 Për Gjyëtimë (Gazeta Zyrtare e Kosovës Nr.08, dt.01.01.2007), nenit 8 paragrafi 8.1, 8.4 dhe 8.5 Udhëzimit Administrativ NR.10/2007 Kriteret e caktimit të zonave dhe procedurat për themelimin e vendgjyëtimeve, dt. 14/09/2007, me qëllim të organizimit dhe mbarëvajtjes së punëve për themelimin e vendgjyëtimeve të përbashkët, "KALAJA", në bazë të kërkesës për dhënien e pëlqimit për themelimin e vendgjyëtimeve të përbashkët Nr.3743/24, të dt. 25.10.2017, të Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari dhe Zhvillim Rural të Komunës së Novobërdës, pas shqyrtimit të kërkesës, shkresave të lëndës dhe propozimit të dhënë nga komisioni për dhënien ose refuzimin e pëlqimit për themelimin e vendgjyëtimeve të përbashkëta në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, vendosi që të jep pëlqimin për themelimin e Vendgjyëtimeve të përbashkët në territorin e komunës së Novobërdës, me sipërfaqe të përgjithshme prej 23.780.00 ha, si dhe me sipërfaqe prej 16.000.00 ha ku mund të kryhen aktivitete të gjyëtimeve, sipas procedurave të legjislacionit në fuqi.

Me sa u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij pëlqimi.

Kapllan HALIMI

Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Pëlqimi i dërgohet:

- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Pylltarisë;
- Agjencisë Pyjore të Kosovës;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Komuna e Novobërdës – Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, dhe
- Arkivit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL – SKUPSTINA OPSTINA – MUNICIPAL ASSEMBLY

Në bazë të urdhresave të Nenit 12,2 dhe nenit 73,1 Ligjit për Vetqeverisje Lokale, të Republikës së Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtin viti V/nr.72/25Qershor 20100, Udhzimit Administrativ MAVL nr.03/2012, Udhzimit Administrativ të MPB-me, nr.27/2012 dhe nenit 34.6 të Statusit të Komunës së Novobërdës:

PROPOZIM VENDIMIN

MBI

FORMIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSB)

I

I. Formohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Novobërdës.

II

1. Svetislav Ivanovic - Kryetar i Komunës;
2. Sinisa Dimic – Nënkyetra i Komunës;
3. Bajrush Ymeri – Nënkyetar i Komunës për Komunitete;
4. Gani Huruglica – Komandant i Stacionit Policor;
5. Nazim Gashi – Përfaqësues i Komunitetit Musliman;
6. Stevo Mitriq – Përfaqësues i Komunitetit Ortodoks;
7. Bastri Abdyli – Përfaqësues i Komuniteteit Shqiptar;
8. Sercan Todoroviq – Përfaqësues i Komunitetit Serb;
9. Selver Jashari – Përfaqësues i Komunitetit Rom;
10. Shpresa Kqiku – Kryesuese e Komitetit për Komunitete;
11. Sadbere Vllasaliu – Zyrtare e Zyres për Barazi Gjinore;
12. Flamur Uka – Zyrtar i Arsimit;
13. Dragan Vasiq – Kryetar i këshillit të prinderve të Arsimit në Komunë;
14. Kap. Fejzullah Fejzullahu - Përfaqësuesi i FSK-së
15. Novica Petrovic – Kryetar i ekipes për veprim në sigurin e komuniteteve;
16. Ivan Ristic – Sektori civil i emergjences Komunale;
17. Jasmina Denic – Shefe e ZKKK;
18. Sillobodan Bogdanovic – OJQ
19. Goran Cvektovic – Përfaqësues i mediave lokale;
20. Jova Simic – Përfaqësues i Bizenseve.
21. Dragan Markovic – Përfaqësues i komitetit lokal të sigurisë publike

III

II. Vendimi hyn në fuqi nga dita e aprovimit nga K.K Novobërdë.

Datum : 15.04.2019
Në: Novobërdë

Kryesuesi i Kuvendit